



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË  
MËSUESVE TË LËNDËS “HISTORI”**

**SHKURT, 2024**

**Ines Todhe**

## TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	3
II. QËLLIMI I PROGRAMIT .....	3
III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit.....	5
3.1.1 <i>Fushat kryesore të zhvillimit profesional</i> .....	5
3.1.2 <i>Modele të testeve për secilin nivel arsimor AMU dhe AML</i> .....	12
3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit23	
3.2.1 <i>Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML</i> .....	23
3.2.2 <i>Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur</i> .....	34

## **I. HYRJJE**

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së historisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së historisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit, si dhe për përgatitjen e orës së hapur mësimore për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit,
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

## **II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT**

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi janë:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së historisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

### ***Programi ka për qëllim që mësuesi:***

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësi shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritetet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një domosdoshmëri në mësimdhënien me kompetenca bazuar dhe në modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

### **III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

**Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në dy pjesë:**

3.1 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë rubrikë përfshihen, përveç kompetencave profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, edhe dy modele testesh për lëndën e historisë në secilin nivel arsimor: arsim i mesëm i ulët (AMU) dhe arsim i mesëm i lartë (AML).*

3.2 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë* (Mësues mjeshtër) të kualifikimit. Në këtë rubrikë ka dy modele orësh mësimore për lëndën e historisë në secilin nivel arsimor: *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

### **3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit**

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat kryesore të zhvillimit profesional, si dhe modele testesh për AMU dhe AML

#### **3.1.1 Fushat kryesore të zhvillimit profesional**

Ky program është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- dokumentacioni zyrtar<sup>1</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;
- programe lëndore të historisë;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimor të lëndës së historisë;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të historisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

<b>FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”</b>	
<b>Kompetenca</b> “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit	<b>Literatura e rekomanduar</b>

<sup>1</sup>Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<b>shkollor”</b>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>• Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022).</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>

<b>FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË HISTORISË”</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të historisë në shkollë”</b>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> <li>• përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>• përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</li> <li>• harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathhtësitë e programit;</li> <li>• kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;</li> <li>• tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të historisë);</li> <li>• përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e historisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	<p>IX, 2014.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.</li> </ul>
--	--

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut  
NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

<p align="center"><b>Kompetenca I</b></p> <p align="center"><b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e historisë”</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>• përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>• demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>• identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> <li>• planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së historisë;</li> <li>• edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkuesinë ndaj lëndës së historisë;</li> <li>• motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>• krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca II</b></p> <p><b>“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e historisë”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>• planifikoi një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>• përdor kërkimin si pjesë e metodologjisë në mësimdhënien – nxënien e historisë;</li> <li>• demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>• shpjegon parimet e hartimit të një testi për nxënësit.</li> </ul>	<p>historisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi “Adresimi i antisemitizmit në shkollë”</li> <li>• Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP 2020 Lënda: histori.</li> <li>• Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: histori.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në histori”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezanton ngjarje/çështje historike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word;</li> <li>• nxit nxënësit të bëjnë kërkime dhe prezantime duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>• gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së historisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website, si dhe prezantime në PowerPoint, Prezi ..</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së historisë që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</li> <li>• Urdhër nr. 84 datë 06.05.2021, për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”.</li> <li>• Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.</li> </ul>

**FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”**

<p><b>Kompetenca</b></p> <p><b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si</b></p>	<p><b>Literatura</b></p>
---	--------------------------

elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> </ul>

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca “Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	Literatura
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;</li> <li>• demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së historisë”	Literatura e rekomanduar
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e historisë në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• përshkruan konceptet historike për klasat VI-IX dhe X-XII;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programe dhe tekste të lëndës së historisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive;</li> <li>• dallon ndërvarësinë e koncepteve historike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> <li>• shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhave të ndryshme historike për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre, bazuar në burimet historike;</li> <li>• shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike;</li> <li>• komunikon njohuritë historike në forma të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;</li> <li>• ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat dhe ngjarjet e rëndësishme historike;</li> <li>• shpjegon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë, për ngjarje/çështje të ndryshme historike;</li> <li>• përdor burimet historike për të shpjeguar arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve historike për periudha të ndryshme të historisë;</li> <li>• dallon se si njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike, bazuar në burimet historike;</li> <li>• vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme;</li> <li>• interpreton efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;</li> <li>• vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar në raport me</li> </ul>	<p>arsimin e mesëm të lartë.</p>
--	----------------------------------

<p>qytetërimet botërore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;</li> <li>• demonstroi aftësi të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;</li> <li>• shpjegon se lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuars, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.</li> </ul>	
--	--

### 3.1.2 Modele të testeve për secilin nivel arsimor AMU dhe AML

#### Model testi për lëndën e historisë në AMU

##### Dokumentacioni zyrtar shkollor

1. Bazuar në “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, një nxënës që ndjek klasën e tetë të arsimit të mesëm të ulët, ka munguar 35% të orëve vjetore lëndore. Në një rast të tillë, nxënësi: **1 pikë**
  - A) nuk klasifikohet në atë lëndë.
  - B) mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.
  - C) vlerësohet me shkrim nga mësuesi i lëndës për njohuritë dhe konceptet, në të cilat ka munguar.
  - D) vlerësohet me shkrim nga një komision që ngre drejtoria e institucionit arsimor.
2. Përcaktoni cili nga standardet e mëposhtme bën pjesë në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar: **1 pikë**
  - A) Ideat dhe praktikat e qytetarisë.
  - B) Bashkëpunimi me kolegët dhe komunikimi.
  - C) Zhvillimi i njohurive dhe i aftësive të nxënësve rreth teksteve letrare dhe joletrare.
  - D) Gjuha artistike dhe arti pamor.
3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).
  - a) Komisioni i disiplinës në shkollë ngrihet në çdo fillim të vitit shkollor dhe kryesohet nga drejtori i institucionit arsimor. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
  - b) Komisioni i disiplinës në shkollë i merr vendimet me votim të hapur. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

### **Programi lëndor**

4. Mësuesi u drejton nxënësve një pyetje të tillë: “Vlerësoni figurën e ...”. Kjo pyetje i takon nivelit të: **1 pikë**
- A) Njohjes dhe vlerësimit
  - B) Analizës dhe kuptuarit
  - C) Njohjes dhe zbatimit
  - D) Sintezës dhe vlerësimit
5. Shkruani dy prej shkathtësive që parashikon programi i historisë, klasa e nëntë, për temën “Ardhja e osmanëve në Ballkan”: **2 pikë**
6. Shkruani tre nga rezultatet e të nxënit që duhet të fitojë nxënësi për kompetencën historike “përdorimi i burimeve” të përcaktuara në programin e historisë, shkalla e katërt e kurrikulës. **3 pikë**

### **Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë**

7. Qarkoni alternativën e saktë. Kllasteri ose “harta e mendimeve” është një teknikë që e nxit nxënësin të: **1 pikë**
- A) evidentojë të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve;
  - B) mendojë dhe parashikojë rreth asaj që lexon;
  - C) mendojë për të krijuar lidhje midis fakteve;
  - D) shfaq mendimet dhe idetë e tij.
8. Qarkoni alternativën e saktë. Gjatë planifikimit të testit hapi i parë që duhet të kryejë mësuesi është: **1 pikë**
- A) lloji i pyetjes;
  - B) gjatësia e testit;
  - C) specifikimet e testit;
  - D) rezultatet e synuara të të nxënit.
9. Gjatë orës së veprimtarisë praktike me temë “Album me veprimtarë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, nxënësit i kërkohet të evidentojë veprimtarinë e disa prej veprimtarëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Shkruani dy rezultate të nxëni që i përkasin zhvillimit të kompetencës digjitale. **2 pikë**
10. Përcaktoni tre rezultatet e të nxënit për temën “Vetizolimi i shtetit shqiptar dhe kriza e regjimit komunist (1978-1990)”. **3 pikë**
11. Kryeni vlerësimin sipas niveleve të arritjeve për rezultatin e të nxënit “nxënësi shpjegon pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist”
- a) Niveli 2: **1 pikë**
  - b) Niveli 3: **1 pikë**
  - c) Niveli 4: **1 pikë**

12. Hartoni nga një pyetje për secilin nga rezultatet e mëposhtëm.

- a) shpjegon shkaqet e thirrjes së Kuvendit të Lezhës. **1 pikë**
- b) analizon vendimet e Kuvendit të Lezhës duke vlerësuar rëndësinë e tyre. **1 pikë**
- c) analizon tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriotit- Skënderbeu. **1 pikë**

### Aspekte të komunikimit dhe etikës

13. Mësuesi/ja ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi/ja, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën? **1 pikë**

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për parimet themelore mbi të cilat hartohet Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar:

- a) Parimi i përkushtimit të prindërve ndaj nxënësit, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi në lidhje me procesin e të nxënës. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) Parimi i përkushtimit ndaj komunitetit për krijimin e një mjedisi më motivues për arsimin. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

### Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

16. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**

- a) elementet kimikë\_\_\_\_
- b) kollonë makinash\_\_\_\_
- c) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar\_\_\_\_

### Përmbajtja shkencore e lëndës

17. Fisi ilir i enkelejdhëve shtrihej në: **1 pikë**

- A) territorin e Kosovës së sotme;
- B) territorin midis luginave të Semanit dhe Matit;
- C) zonën rreth Durrësit dhe Krujës;
- D) zonën rreth liqenit të Ohrit dhe të Prespës.

18. Kuvendi themelues i Lidhjes së princërve shqiptarë u mbajt në Lezhë sepse: **1 pikë**

- A) Lezha kishte terren të thyer malor;  
 B) Lezha gjendej në një zonë strategjike;  
 C) në këtë mënyrë i bëhej një ftesë për bashkëpunim Venedikut;  
 D) Zoti i Lezhës ishte përkrahësi kryesor i Skënderbeut.
19. Kongresi i Vjenës me vendimet e tij, siguroi: **1 pikë**  
 A) zgjerimin territorial të Francës;  
 B) promovimin e institucioneve demokratike;  
 C) një periudhë të gjatë qetësie për Evropën;  
 D) vendosjen e lidhjeve ekonomike ndërkombëtare.
20. Qëllimi kryesor i politikave ekonomike të ndjekura nga Stalini, ishte të: **1 pikë**  
 A) thithte investime të huaja;  
 B) zhvillonte më shumë industrinë e rëndë;  
 C) prodhonte me bollëk mallra konsumi;  
 D) ndihmonte financiarisht të varfrit për të rritur prodhimin bujqësor.
21. Ligjet e Nurembergut lidheshin me: **1 pikë**  
 A) ndalimin e lirisë së shtypit;  
 B) ndryshimin e formës së regjimit;  
 C) mohimin e të drejtave të hebrenjve;  
 D) eliminimin e veprimtarisë së partive politike.
22. Statuti i Lushnjës përcaktonte si formë të organizimit shtetëror: **1 pikë**  
 A) Monarkinë absolute;  
 B) Monarkinë kushtetuese;  
 C) Republikën Presidenciale;  
 D) Republikën Parlamentare
23. “Faktet provojnë se shumë abuzime ndodhën me urdhër të Stalinit, pa marrë parasysh normat e partisë dhe ligjshmërisë sovjetike. Stalini ishte një njeri shumë dyshues... . Kur Stalini thoshte që dikush duhet të arrestohet, ishte e domosdoshme që të besohej që ai person ishte një “armik i popullit”. Bazuar në pasazhin e mësipërm, cili nga udhëheqësit e BRSS mbajti një qëndrim kritik ndaj figurës së Stalinit? **1 pikë**  
 A) Nikita Hrushov.  
 B) Leonid Brezhnjev.  
 C) Juri Andropov.  
 D) Konstatin Çernjenko.
24. Vendimet e Traktatit të Shën Stefanit nuk u pranuan nga Fuqitë e Mëdha për shkak: **1 pikë**  
 A) se pjesa më e madhe e Shqipërisë i kalonte Serbisë;  
 B) se zgjerohej shumë territori i Perandorisë Osmane;  
 C) të krijimit të një Bullgarie shumë të madhe;

D) të daljes në Adriatik të Turqisë.

25. Prilli i vitit 2009 shënon një nga momentet më të rëndësishme të Shqipërisë pas rrëzimit të sistemit komunist. Për cilën ngjarje bëhet fjalë? **1 pikë**

A) Anëtarësimi në Paktin e Stabilitetit.

B) Marrja e statusit kandidat për BE.

C) Anëtarësimi në NATO.

D) Liberalizimi i vizave.

26. Për pohimet e mëposhtme zgjidhni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse është i gabuar.

a) Konferenca e Mukjes u anulua nga Partia Komuniste Shqiptare. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Në vitin 1946 Shqipëria nënshkroi një konventë ekonomike me Bashkimin Sovjetik. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) Eliminimi i institucioneve fetare në Shqipëri u shpall në kushtetutën e vitit 1976. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

27. Për pohimet e mëposhtme zgjidhni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse është i gabuar.

a) Xhuzepe Garibaldi çliroi Sicilinë. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Bashkimi i Gjermanisë u realizua nga Vilhelmi I. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) Disfata e fundit e Napoleon Bonapartit ishte beteja e Borodinos. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

28. Në kolonën e majtë jepen shtetet, ndërsa në kolonën e djathtë kolonitë e tyre. Lidhni me shigjetë shtetin me koloninë përkatëse. **4 pikë**

Angli

Algjeri

Francë

Indi

Itali

Meksikë

Spanjë

Etiopi

29. Referojuni materialit të mëposhtëm për t' ju përgjigjur kërkesës a) dhe b).


“Përmbajtja e traktatit është që të dy vendet të koordinojnë planet e tyre ekonomike në baza të përbashkëta dhe për këtë arsye do të ngrihen organe koordinimi. Njësia e vlerës së monedhës do të jetë e barabartë për të dy vendet, prandaj Republika shqiptare duhet të shpjerë vlerën e njësisë së monedhës baras me dinarin.

Qeveria e R. F. P. të Jugosllavisë angazhohet në këtë traktat të furnizojë Shqipërinë me plaçkë tregu dhe material të caktuar në marrëveshje, që parashikohet sipas koordinimit të planeve për të mbajtur vlerën e lekut baras me dinarin.

Të dy qeveritë angazhohen që brenda një muaji të zhduken kufijtë doganorë dhe doganat në mes të dy vendeve, duke krijuar një territor doganor mik, në krye të secilit do të ketë një komision shqiptaro-jugosllav.”

*(Nga “Traktati mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave midis R. P. të Shqipërisë dhe R. F. P. të Jugosllavisë”, nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946.)*



- a) Duke u mbështetur në paragrafët mbi “Traktatin ekonomik”, shpjegoni natyrën e marrëdhënieve ekonomike shqiptaro – jugosllave në vitet 1945 - 1948. **2 pikë**
- b) Duke u mbështetur në paragrafët mbi “Traktatin ekonomik, jepni një argument nëse këto marrëveshje ishin apo jo në favor të ekonomisë shqiptare. **1 pikë**
30. Në fotografi paraqitet akti i nënshkrimit të Pavarësisë së Shqipërisë. Jepni tri argumente pse shpallja e pavarësisë së Shqipërisë ishte një nga ngjarjet me të rëndësishme për vendin tonë? **3 pikë**
- 
31. “Historiani Bizantin Prokopi, për dyndjet sllave në Ballkan shkruan: “...Si një valë deti prej njerëzish, me burra, gra e fëmijë ata u vërsulën në tokat e perandorisë dhe i kthyen në gërmadha ... Ilirinë, Epirin, dhe Thrakinë duke përparuar deri në Greqinë e vjetër... .” Përcaktoni dy nga ndryshimet që ndodhën në Ballkan si pasojë e dyndjeve sllave. **2 pikë**
32. Identifikoni dy nga rrugët që ndoqi Skënderbeu për të arritur synimet e tij për një shtet të përqendruar. **2 pikë**
33. Cilat ishin dy nga masat që mori qeveria e Vlorës për administrimin e vendit? **2 pikë**
34. Në vitet ‘60 të shekullit XX, u përdor gjerësisht termi detantë.
- a) Shpjegoni kuptimin e termi “Detantë”. **1 pikë**
- b) Cilët ishin dy faktorët që mundësuan detantën? **2 pikë**
35. Në nëntor të vitit 1913 Fuqitë e Mëdha caktuan si princ të Shqipërisë gjermanin Vilhelm Vid
- a) Cilat ishin dy nga masat që mori princ Vidi pasi erdhi në Shqipëri? **2 pikë**
- b) Pse Protokollin e Korfuzit shkeli vendimet e Konferencës së Londrës? **1 pikë**
36. Renditni tri nga shkaqet e fillimit të Luftës II Botërore. **3 pikë**

## Model testi për lëndën e historisë në AML

### Dokumentacioni zyrtar shkollor

1. Bazuar në “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, një nxënës që ndjek klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë, ka munguar 30% të orëve vjetore lëndore. Në një rast të tillë, nxënësi: **1 pikë**
- A) vlerësohet me shkrim nga një komision që ngre drejtoria e institucionit arsimor.
- B) vlerësohet me shkrim nga mësuesi i lëndës për njohuritë dhe konceptet, në të cilat ka munguar.
- C) nuk klasifikohet në atë lëndë.
- D) mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.

2. Bazuar në standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, një mësues analizoi të gjithë treguesit e standardit “Vlerësimi i të nxënit”. Nga vetëvlerësimi i treguesve të këtij standardi, i rezultoi që mesatarja e pikëve për këtë standard ishte 3,6. Përcaktoni nivelin e arritjes së këtij standardi që korrespondon me këtë mesatare të pikëve:

**1 pikë**

- A) Niveli 1
- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë mësuesi që zgjidhet kryetar i ekipit lëndor:
- a) Të ketë punuar të paktën 10 vjet si mësues në po atë nivel arsimor. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
  - b) Të jetë vlerësuar me të paktën “Shumë mirë” në provimin e kualifikimit, nëse e ka dhënë provimin. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

#### **Programi lëndor**

4. Qarkoni alternativën e saktë. Cilës prej tematikave të mëposhtme i takon “Traktati i Fshehtë i Londrës”, në historinë e klasës së 11-të? **1 pikë**
- A) Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912 – 1939.
  - B) Shqiptarët në fund të shekullit XIV deri në fillimin e shekullit XX.
  - C) Shqiptarët dhe lufta e dytë botërore 1939 – 1944.
  - D) Shqipëria gjatë regjimit komunist 1944 – 1990.
5. Shkruani një kompetencë lëndore që zhvillon dhe mat secili rezultat i mëposhtëm i të nxënit:
- a) Shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndryshimit të shoqërisë në parahistori. **1 pikë**
  - b) Evidenton tezat e ndryshme për etnogjenezën e ilirëve. **1 pikë**
6. Shkruani tre rezultate të nxëni për realizimin e kompetencës lëndore përdorimi i burimeve gjatë shkallës së pestë së kurrikulës: **3 pikë**

#### **Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë**

7. Qarkoni alternativën e saktë. Në cilin grup të metodave të mësimdhënies bën pjesë ekskursioni? **1 pikë**
- A) Metodatat e punës në grup.
  - B) Metodatat e hulumtimit.
  - C) Metodatat e mendimit kritik.
  - D) Metodatat e mendimit krijues.
8. Qarkoni alternativën e saktë. Cilit prej niveleve të arritjeve i përket vlerësimi me notën 7-të?

**1 pikë**

- A) Niveli 1

- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

9. Jepni dy shembuj të përdorimit të TIK si pjesë e metodologjisë për temën “Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare”: **2 pikë**
10. Përcaktoni tri nga kategoritë e taksonomisë së Blumit. **3 pikë**
11. Për vlerësimin e nxënësit, hartoni tre nivelet e arritjes për përmbushjen e rezultatit të të nxënësit: “Dallon tiparet ekonomike e shoqërore të fiseve ilire nga shekulli V deri në shekullin II para Krishtit”.
- Niveli 2 **1 pikë**
  - Niveli 3 **1 pikë**
  - Niveli 4 **1 pikë**
12. Shkruani tri kushte që ndikojnë në përzgjedhjen e metodologjisë mësimore: **3 pikë**

#### **Aspekte të komunikimit dhe etikës**

13. Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi: **1 pikë**
- A) vendos të njëjtat rezultate të nxënë për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
  - B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
  - C) vendos rezultate të nxënë të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
  - D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.
14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për treguesit e parimit të përkushtimit ndaj komunitetit të përcaktuara në Kodin e etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar:
- a) Mësuesi jeton në komunitet dhe për të. Ai ka në qendër të interesit të tij kthimin e shkollës, gjithnjë e më shumë, në qendër komunitare. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
  - b) Mësuesi pranon që trashëgimia gjuhësore dhe kulturore, familja dhe komuniteti nuk modelojnë marrëdhëniet e shkollës me komunitetin. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

#### **Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe**

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**
- A) viti 11-të i shkollës
  - B) viti i 11 i shkollës
  - C) viti i 11-t i shkollës
  - D) viti i 11-të i shkollës
16. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**
- a) livadhe të gjelbër\_\_\_\_
  - b) atllas gjeografik\_\_\_\_

c) Instituti i Shëndetit Publik\_\_\_\_

### **Përmbajtja shkencore e lëndës**

17. Një nga pasojat e përfundimit të Luftës 100 vjeçare mes Anglisë dhe Francës solli: **1 pikë**  
A) fitoren e Francës dhe përqendrimin e plotë të pushtetit republikan;  
B) fitoren e Francës dhe përqendrimin e plotë të pushtetit monarkik;  
C) fitoren e Anglisë dhe shpalljen e saj monarki parlamentare;  
D) fitoren e Anglisë dhe shpalljen e saj monarki absolute.
18. Cila prej ideve të mëposhtme i përket iluministit Zhan Zhak Ruso? **1 pikë**  
A) Kritika e klerikalizmit dogmatik.  
B) Vendosja e formës republikane të qeverisjes.  
C) Qeverisja e kufizuar në raport me të drejtat e njeriut.  
D) Ndarja dhe pavarësia e pushteteve brenda një shteti.
19. Ishte pasojë e drejtpërdrejtë e Reformacionit: **1 pikë**  
A) Lufta 30-vjeçare;  
B) Skizma e Madhe;  
C) Lufta e Madhe fshatare në Gjermani;  
D) Ndryshimi i hartës fetare të Evropës.
20. Federalizmi ishte një nga parimet e: **1 pikë**  
A) Deklaratës së Pavarësisë;  
B) Artikujve të Konfederatës;  
C) Kushtetutës amerikane të vitit 1787;  
D) Politikës angleze në Amerikën e Veriut.
21. Përdorni informacionin e mëposhtëm për t'iu përgjigjur pyetjes. **1 pikë**  
“Miq të mi të mirë, për herë të dytë në historinë tonë, një kryeministër britanik është kthyer nga Gjermania duke sjellë paqe me nder. Unë besoj se kjo është paqja e kohës sonë... . Shkoni në shtëpi dhe flini të qetë.”  
*Neville Chamberlain, (Deklaratë pas kthimit të tij nga Konferenca e Mynihut.)*  
Bazuar në deklaratën e mësipërme, cila prej politikave të mëposhtme do të parandalonte një luftë të re?  
A) Politika e izolimit.  
B) Politika e lëshimeve.  
C) Politika e kundërpërgjigjes.  
D) Politika e dëmshpërblimeve.
22. Holokausti ishte keqtrajtimi dhe shfarosja gjatë Luftës së Dytë Botërore e: **1 pikë**  
A) Romëve;  
B) Hebrenjve;  
C) Ushtarëve italianë;  
D) Dezertorëve të luftës.

23. Cili prej pohimeve të mëposhtme ishte shkak për kolapsin ekonomik të sistemit komunist në Shqipëri? **1 pikë**
- A) Rritja e iniciativës ekonomike private në vitet '80.  
 B) Rritja e eksporteve të produkteve shqiptare.  
 C) Racionimi i ushqimit nëpërmjet tollonave.  
 D) Administrimi i centralizuar i ekonomisë.
24. Një nga karakteristikat e ekonomisë gjatë sistemit komunist në Shqipëri ishte: **1 pikë**
- A) privatizimi i ndërmarrjeve me kapital vendas;  
 B) zbatimi i ekonomisë së tregut të lirë;  
 C) privatizimi i ndërmarrjeve të huaja;  
 D) eliminimi i pronës private.
25. Hartimi i Kodit Penal, Civil dhe Tregtar me standarde evropiane u bë gjatë viteve të: **1 pikë**
- A) Qeverisë së Sulejman Delvinës (1920);  
 B) Qeverisë së Fan Nolit (1924);  
 C) Republikës Shqiptare (1925-1928);  
 D) Monarkisë Shqiptare (1928-1939).
26. Për pohimet e mëposhtme zgjidhni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse ai është i gabuar.
- a) Lëvizja protestante njihet ndryshe me emrin Reformacion. V/G\_\_\_\_\_ **1 pikë**  
 b) Lufta civile në SHBA u udhëhoq nga Abraham Linkoln. V/G\_\_\_\_\_ **1 pikë**
27. Për pohimet e mëposhtme zgjidhni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse është i gabuar.
- a) Vendosja e regjimit monarkik pas lufte dhe rikthimi i mbretit Zogu I, ishte pjesë përbërëse e programit politik të Ballit Kombëtar. V/G\_\_\_\_\_ **1 pikë**  
 b) Ndalimi me ligj i fesë në Shqipëri, u vendos në kushtetutën e vitit 1976. V/G\_\_\_\_\_ **1 pikë**  
 c) Shkëputja e marrëdhënieve diplomatike/ekonomike të Shqipërisë me shtetet e tjera në rend kronologjik është si vijon: Jugosllavi – BashkimSovjetik – Kinë.V/G\_\_\_\_\_ **1 pikë**
28. Disfata e fundit e Napoleon Bonapartit ishte beteja e \_\_\_\_\_. **1 pikë**
29. “Ahmet Zogu qe kthyer në pushtet me ndihmën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, kryesisht sepse ajo shpresonte të kënaqeshin pretendimet e saj territoriale. A. Zogu ishte i vendosur t'i jepte fund vështirësive ekonomike, që cikloheshin në mënyrë të pandërprerë. Në këto rrethana, kursi i tij ishte të kthehej nga Italia dhe njëkohësisht ta zbuste Jugosllavinë duke i njohur pretendimet e saj ”.

*JosephSuire, “Ngritja e një Mbretërie”*

a) Identifikoni ndryshimin territorial që ndodhi mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, me rikthimin në pushtet të Ahmet Zogut.

**1 pikë**

b) Shpjegoni dy nga arsyet pse marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene nuk patën jetëgjatësi.

**2 pikë**

30. Nga nënshkrimi i Traktatit të Verdunit (viti 843) lindën shtetet e \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_.

**3 pikë**

31. Në kolonën e majtë jepen kongreset e mbajtura në Shqipëri, ndërsa në kolonën e djathtë vendimet që janë marrë në këto kongrese. Lidhni me shigjetë kongresin me vendimin përkatës.

**4 pikë**

Kongresi i Elbasanit  
Kongresi i Manastirit  
Kongresi i Përmetit  
Kongresi i Lushnjës

Krijimi i qeverisë më në krye Sulejman Delvinën  
Ndalimi i rikthimit të ish-mbretit Zog në Shqipëri  
Caktimi i alfabetit shqip  
Ngritja e shkollës normale për përgatitjen e mësuesve

32. Në kolonën e majtë jepen tiparet e ekonomisë, ndërsa në kolonën e djathtë shtetet ku janë aplikuar. Lidhni me shigjetë sistemin ekonomik me shtetin përkatës.

**3 pikë**

Shteti luan rolin kryesor në drejtimin e ekonomisë, por u ruajt pronat private

Rusi

U kolektivizua bujqësia dhe u shtetëzua industria

Gjermani

Krijimi i kushteve për funksionimin e tregut të lirë

SHBA

33. Reformacioni i kishës katolike shënon një moment kulmor në historinë evropiane. Zbatimi në praktikë i tezave të Luterit pati rrjedhoja shumë dimensionale si në kuadrin e ngushtë fetar dhe kishtar, ashtu edhe në atë politik.

Jepni dy detyrat që shtroi Luteri për përhapjen e tezave të tij.

**2 pikë**

34. Në gusht 1943 në takimin e mbajtur në Mukje morën pjesë përfaqësues të Frontit Nacional Çlirimtar dhe të Ballit Kombëtar.

a) Evidentoni një nga vendimet e marra me miratimin e përfaqësuesve të dy palëve në këtë takim.

**1 pikë**

b) Shpjegoni dy arsyet pse PKSH i hodhi poshtë pikat e kësaj marrëveshjeje.

**2 pikë**

35. Perandresha më e njohur e Rusisë ishte Katerina II ose siç njihet në histori Katerina e Madhe. Qëndrimi që ajo mbajti ndaj fisnikërisë ishte i ndryshëm me atë të Pjetrit të Madh. Identifikoni respektivisht dy nga masat e marra nga këta monarkë reformatorë ndaj shtresës së fisnikërisë.

a) Dy masat që mori Katerina e Madhe:

**2 pikë**

b) Dy masat që mori Pjetri i Madh:

**2 pikë**

36. Renditni tri nga shkaqet e krizës ekonomike në Shqipëri në vitet '80 të shek. XX.

**3 pikë**

### ***3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, në udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenaduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në dhe për AML-në si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

#### **3.2.1 Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML**

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AMU dhe AML. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: IV	Klasa: 9
<p><b>Tema mësimore:</b></p> <p>Kosova dhe Çamëria gjatë Luftës së Dytë Botërore</p>	<p><b>Situata e të nxënit:</b></p> <p>Lexohet thirrja e përbashkët e KQ të Partisë Komuniste Shqiptare dhe Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit.</p> <p><i>“Në këtë luftë çlirimtare, ku luhet fati i popujve, duhet që dhe ne të marrim pjesë me armë në dorë për të shpëtuar njëherë e mirë prej robërisë. Prandajta lidhni luftën tuaj me atë të vëllezërve tuaj në Shqipëri, si dhe me luftën e vendeve fqinj të Malit të Zi, Serbisë e të Greqisë. Formoni çetat tuaja partizane dhe bashkëpunoni me ato të partizanëve jugosllavë. Formoni sa më parë frontin e përbashkët me të gjithë popujt kundër armiqve të përbashkët, pasi kjo është rruga e vetme për të fituar lirinë dhe të drejtën e vetëvendosjes”.</i></p> <p>(Marrë nga Historia e popullitshqiptar, vëllimi 4, f. 133)</p> <p>Pas leximit mësuesi ju kërkon nxënësve tu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Si e kuptoni këtë thirrje?</li> <li>– Përse shërbente kjo thirrje e përbashkët?</li> <li>– Cilët janë popujt që përfitojnë nga krijimi i frontit të përbashkët kundër pushtuesit?</li> </ul>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit:</b></p> <p>Nxënësi/-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan administrimin e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>• Analizon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>• Vlerëson qëndresën e popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve;</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <p>Zonë pushtimi, e drejtë kombëtare, Lidhja e Dytë e Prizrenit, parimi i vetëvendosjes Konferenca e Bujanit.</p>		



<p><b>Burimet</b> :“Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945”, autor Dr. Haxhi Ademi, linku: <a href="https://ih-rks.org/kosova-gjate-luftes-se-dyte-boterore-1941-1945/">https://ih-rks.org/kosova-gjate-luftes-se-dyte-boterore-1941-1945/</a>;</p> <p>Monografia me titull “Çështja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore” me autor Dr.LorencAgalliu, linkun: <a href="https://unitir.edu.al/ceshtja-came-gjate-luftes-se-dyte-boterore-2/">https://unitir.edu.al/ceshtja-came-gjate-luftes-se-dyte-boterore-2/</a></p> <p>Fotografi dhe ilustrime.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Gjuhët dhe komunikimi</li> <li>– Qytetari</li> <li>– Gjeografi</li> <li>– TIK</li> </ul>
---	--

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** janë përzgjedhur duke konsideruar dhe stilet e të nxënësve: dëgjimor; kinestik; pamor; lexim-shkrim.

FAZAT	STRATEGJITË	VEPRIMTARITË E NX.	ORGANIZIMI I NX.
P	Parashikimi me terma paraprakë	Nxitja e diskutimit	Punë çifte dhe me gjithë klasën
N	Lojë me role	Ndërtimi i kompetencave historikedhe kyçe	Punë në grupe
P	Diagrama e Venit Pyetje- Përgjigje	Paraqitja grafike	Punë në dyshe

### Organizimi i orës së mësimi

#### Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (parashikimi me terma paraprakë)

Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat dhe vitet: Kosovë, pushtues, Çamëri, Lufta e Dytë Botërore, qëndresë, viti 1941, 1942, 1943, 1944.

- Nxënësit, në çift të shkruajnë nga një fjali me këto terma dhe i vendosin në linjën e kohës sipas viteve.
- Linja e kohës dhe fjalitë e ndërtuara vendosen të gjitha në tabelë dhe lexohen nga mësuesi.
- Nxënësit pyesin për informacionin e panjohur ose për ta saktësuar atë.

#### Ndërtimi i njohurive të reja- klasa organizohet në grupe, metoda është Loja me role

Mësuesi/ja për të ndarë klasën në grupe përdor muajin e lindjes së tyre, duke i kërkuar të ngrihen në këmbë, të rreshtohen njëri pas tjetrit, sipas muajit në të cilin kanë lindur dhe i ndan në 6 grupe.

Mësuesja ndan 5 fisha për rolet që do të këtë çdo nxënës i grupit dhe së bashku me to edhe informacionet e detyrat për çdo grup:

#### **Udhëheqësi**

Shpërndan informacionin dhe është përgjegjës për të siguruar që detyrat të kryhen në kohën e caktuar.

#### **Inkurajuesi**

Siguron që të gjithë të marrin pjesë në diskutim dhe mendimet e të gjithëve të dëgjohen.

#### **Raportuesi**

Raporton për rezultatet e punës së grupit dhe nëse është e nevojshme komunikon me mësuesin.

#### **Mendja krijuese**

Inkurajon të menduarit krijues dhe paraqet perspektiva befasuese.

#### **Vlerësuesi**

Siguron që grupi të vlerësojë atë që ka bërë, atë që ka mësuar dhe mendon se si mund të përmirësohet puna.

Mësuesi/ja ka marrë materialet nga botimet dhe ia shpërndan nxënësve ose orienton nxënësit të përzgjedhin dhe shqyrtojnë informacionin nga interneti:

1. “Kosova gjatë luftës së dytë botërore 1941-1945”, autor Dr. Haxhi Ademi ose duke klikuar mbi linkun: <https://ih-rks.org/kosova-gjate-luftes-se-dyte-boterore-1941-1945/>;
2. Monografia me titull “Çështja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore” me autor Dr.LorencAgalliu ose duke klikuar në linkun: <https://unitir.edu.al/ceshtja-came-gjate-luftes-se-dyte-boterore-2/>

#### **Detyrat për secilin grup janë:**

**Gr.1:** Përshkruani organizimin administrativ të Kosovës;

**Gr.2:** Evidento pasojat e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë;

**Gr.3:** Si dhe pse populli i Kosovës bëri qëndresë ndaj pushtuesit?

**Gr.4:** Pse u organizua Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe cilat janë vendimet e saj?

**Gr.5:** Kur dhe pse u mbajt Konferenca e Bujanit dhe cilat janë vendimet e saj?

**Gr.6:** Përshkruaj veçoritë e qëndresës e shqiptarëve të Greqisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Nxënësit, sipas roleve që i janë caktuar kontribuojnë në përfundimin e punës në grup. Pasi përfundon puna, çdo grup vendos punën e tij në një faqe muri të klasës dhe e prezantojnë atë përpara grupeve të tjera. Pas çdo prezantimi nxënësit vlerësojnë punën e bërë nga çdo grup dhe duartrokin.


#### **Reflektimi**

##### **Metoda Diagrami i Venit**

- Mësuesi/ja ndan nxënësit në çifte dhe kërkon nga ata të ndërtojnë në fletë A4 ose fletore skemën e

diagramit të venit. Nxënësit plotësojnë skemën sipas modelit të mëposhtëm.

### Diagrami i Venit



Veçoritë dalluese
<b>Kosova:</b>
1.
2.
3.
<b>Çamëria:</b>
1.
2.
3.

Të përbashkëta
<b>Kosova dhe Çamëria:</b>
1.
2.
3..

Lexohen përgjigjet dhe mësuesi/ja sqaron apo shpjegon konceptet apo informacionin e paqartë.

#### Pyetje-përgjigje

- Ku qëndron dallimi ndërmjet Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe Konferencës së Bujanit?
- Pse udhëheqja komuniste jugosllave u shpreh për mospranimin e rezolutës së Konferencës së Bujanit?
- Cilat janë parimet mbi të cilat duhej të ngrihej rezistenca e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi?
- Jepni gjykimin tuaj mbi përparësitë dhe mangësitë e këtyre parimeve.

**Vlerësimi** (vlerësohen nxënësit për kërkimin historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak-pasojë, interpretimin dhe prezantimin bazuar në argumentet që japin, kontributin në punën në grup dhe punën me hartën, përdorimin e TIK)

**Vlerësimi i nxënësve sipas niveleve të arritjes**

#### Niveli 2:

- Përshkruan me ndihmën e mësuesit ndonjë nga treguesit e administrimit të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Identifikon ndonjë nga shkaqet e qëndresës së shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Tregon ndonjë nga vlerat e qëndresës së popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve.

### **Niveli 3:**

- Përshkruan disa nga treguesit të administrimit të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Analizon disa nga treguesit e qëndrimit të shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Vlerëson disa tregues të qëndresës së popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve.

### **Niveli 4:**

- Përshkruan administrimin e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Analizon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Vlerëson qëndresën e popullit të Kosovës dhe Çamërisë kundër pushtuesve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Zgjidhni një nga detyrat e mëposhtme dhe prezantoheni në PowerPoint ose Word:

1. Ese për qëndresën e popullit të Kosovës dhe të Çamërisë në Luftën e Dytë Botërore.
2. Informacion për qëndresën e shqiptarëve të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore.
3. Informacion kontributin e dhënë nga popullsia çame gjatë Luftës së Dytë Botërore.
4. Album me fotografi me momente të qëndresës së popullit të Kosovës dhe Çamërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Shkalla: IV	Lënda: Histori	Shkalla: 5	Klasa: 10
<b>Tema mësimore</b> Revolucioni Amerikan. Kushtetuta (45 minuta)		<b>Situata e të nxënit:</b> SHBAçdo 4 korrik feston Ditën Kombëtare të Shteteve të Bashkuara me fishekzjarrë, parada karnavale, panairë, piknik, festim familjare. Përgjigjuni pyetjeve: – Si mendoni me cilën ngjarje lidhet kjo ditë? – Çfarë ju kujton T. Xheferson? – Po AbrahamLinkoln?	
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> 1. Përcakton shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive Angleze të Amerikës së Veriut. 2. Analizon shkaqet e luftës civile dhe rrjedhojat e saj 3. Vlerëson rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë dhe rolin e Kushtetutës amerikane në qytetërimin botëror.		<b>Fjalët kyç:</b> Deklarata e Pavarësisë, abolicionistë, luftë civile, merkantilizëm, konfederatë, koloni, bojkot, lëvizje federaliste, fuqi supreme, forca unioniste, ndarje pushtetesh.	
<b>Burimet:</b> Histori 10, Interneti. Wikipedia sq.m.wikipedia.org <b>Mjetet:</b> Foto e figurave të Revolucioni Amerikan Deklaratës së Pavarësisë, harta e Amerikës, video projektor.		<b>Lidhja me fushat e tjera të të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjuha dhe komunikimi, TIK-u, Gjeografia, Qytetaria</li> </ul> <b>Lidhja me temat ndërkurikulare:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</li> </ul>	
<b>Organizimi i orës së mësimi:</b>			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b> janë përzgjedhur duke konsideruar dhe stilet e të nxënit: dëgjimor; kinestik; pamor; lexim-shkrimi.			
Fazat	Strategjitë	Veprimtaritë e nxënësve	Organizimi i nxënësve
P	Stuhi mendimesh	Nxitja e diskutimit	Punë me gjithë klasën
N	Harta e konceptit	Ndërtimi i kompetencave historike dhe kyçe	Punë në grupe

P	Diagrami i Venit	Paraqitja grafike	Punë në dyshe
---	------------------	-------------------	---------------

**Parashikimi**

Mësuesi/ja nëpërmjet pyetjeve më poshtë sjell në vëmendje të nxënësve njohuritë e mëparshme nëpërmjet lidhjes me revolucionin Anglez.

Mësuesi/ja pyet:

- Si u kufizua pushteti i mbretit në Angli?
- Cili ishte ndryshimi midis revolucionit dhe revolucionit të lavdishëm?
- Çfarë qeverisje pati Anglia pas revolucionit?
- Cili qe karakteri i Aktit të të Drejtave të Njeriut?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre për pyetjet e mësipërme.

**Brainstorming:**

Nxënësit shikojnë një dokumentar në lidhje me shpalljen e Pavarësisë së SHBA

[https://youtu.be/cdVJij8EdPg\\_pasi](https://youtu.be/cdVJij8EdPg_pasi) shikohet dokumentari diskutohet situata e të nxënës dhe nxiten

nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Si mendoni me cilën ngjarje lidhet kjo ditë?
- Çfarë ju kujton T. Xheferson?
- Po AbrahamLinkoln?
- Nxirrni një fakt dhe një opinion nga video që patë.


**Veprimtari:** Ndërtimi i fjalorit. Përcaktoni termat e mëposhtëm bazuar në të kuptuarit e kontekstit historik. Nxënësit plotësojnë tabelën më poshtë në çift duke konsideruar dhe stilet e të nxënës: dëgjimor; kinestik; pamor; lexim-shkrim.

Terma	Përkufizimi
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Luftë Civile</li> <li>- Shtete të Unionit</li> <li>- Konfederatë</li> <li>- Abolicionistë</li> <li>- Koloni</li> </ul>	

**Ndërtimi i njohurive**

Realizohet njohja e nxënësve me kompetencat e orës

**Më pas nxënësit sistemojnë njohuritë:**



**Veprimtaria:** Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe (teknika me numërim 1,2,3,4,5) duke i udhëzuar ata të lexojnë çështjet mësimore.

### Grupi 1: Shkaqet e luftës për pavarësi

1. Koloni britanike
2. Nuk përfaqësoheshin në parlament
3. Vareshin nga sistemi merkantilist britanik
4. Rritja e taksave për shkak të luftës 7-vjeçare me Francën

### Grupi 2: Zhvillimi i luftës:

Masaçustesi qendra e luftës antibritanike

Filadelfia: Kongresi i parë Kontinental vendosi:

zhvillimin e protestave, krijimin e komisioneve për bojkot dhe mbledhjen e Kongresit të dytë.

Kongresi 2 maj 1775 udhëzoi T. Xheferson të hartonte Deklaratën e Pavarësisë 4 korrik

1776 shkëputja nga B.M


### Grupi 3: Kushtetuta:

1787 Konventa miratoi Kushtetutën:

SHBA shtet federal

ndarja e pushteteve:legjislativ (kongresi) ekzekutiv (presidenti)  
gjyqësor( gjykatat federale)

**Grupi 4: Lufta civile:**



**Grupi 5:**

Shkaqet e luftës civile. Duke pasur parasysh arsyet pas shpërthimit të Luftës Civile, zgjidhni dy prej shkaqeve që ju i konsideroni si çështja më urgjente që shkaktoi këtë ngjarje. Citoni fakte historike për të mbështetur përgjigjen tuaj.

1

2

Nxënësit sipas grupeve pasqyrojnë momentet kyçe që ata kanë nxjerrë nga leximi. Më pas kalohet në diskutimin e këtyre çështjeve.

Ndërtimi i shprehive studimore.

Në përfundim mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të vazhdojnë punën me plotësimin e Diagramit të



Venit

**Veprimtari:** Diagrami i Venit

Nxënësit nxjerrin të përbashkëtat e të veçantat e Revolucionit Anglez dhe Amerikan

Revolucionit Anglez	Të përbashkëtat	Revolucionit Amerikan
1.		1.
2.		2.
3.		3.
4.		4.

### **Pyetje**

Pas plotësimit të tabelës mësuesi/ja drejton pyetjet:

- Ku qëndron rëndësia e miratimit të Deklaratës së Pavarësisë?
- Pse themi që SHBA merret si shembulli i demokracisë në botë?
- Cilat qenë efektet e Luftës Civile?

**Vlerësimi** (*vlerësohen nxënësit për kërkimin historik, përdorimin e burimeve, analizën shkak-pasojë, interpretimin dhe prezantimin bazuar në argumentet që japin, kontributin në punën në grup dhe punën me hartën, përdorimin e TIK))*

### **Vlerësohet në nivelin N2:**

Nxënësi që përcakton shkaqet e luftës për Pavarësi dhe vendimet e Kongresit I-rë Kontinental

### **Vlerësohet në nivelin N3:**

Nxënësi që analizon shkaqet, zhvillimin e pasojat e Luftës Civile?

### **Vlerësohet në nivelin N4:**

Nxënësi që vlerëson përmbajtjen e Deklaratës së Pavarësisë, Kushtetutës Amerikane dhe rolin e tyre në demokracinë botërore

### **Detyra dhe punë e pavarur. Linja e kohës**

Nxënësi përcakton në linjën e kohës ngjarjet më të rëndësishme historike që çuan në shpërthimin e luftës civile deri në përfundim të saj.

1820-Kompromisii Misisurit 1861

1619–Ardhja e  
sklleverve  
të parë  
nga Afrika.

1776

### 3.2.2 Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

#### Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 70 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
<b>Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)</b>				
<b>Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësit</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënëit (RN) nuk bazohen në programin lëndordhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxënëit. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënëit. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënëit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënëit, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënëit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënëit. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënëit, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	<b>4 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënëit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënëit, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe teknikat mësimore janë në një koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënëit dhe me stilet e të nxënëit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	<b>5 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënëit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënëit të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënëit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
<b>Mësuesi ka planifikuar për</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka një	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi në	<b>4 pikë</b> Mësuesi në	<b>5 pikë</b> Mësuesi në

<p><b>temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore</b></p>	<p><i>planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>
--	---	---	--	--

#### Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)

<p><b>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimet vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i></p>
<p><b>Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxitin të marrin pjesë në</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimet duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të</i></p>

<b>vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</b>	<i>mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
<b>Metodat mësimore (21 pikë)</b>				
<b>Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të nxënimit</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeh stilet e të nxënimit. Ora e mësimi është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënimit të nxënësve të tij por ora e mësimi është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënimit.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënimit të nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimi nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënimit duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që njeh shumë mirë stilet e të nxënimit të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënimit duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.</i>
<b>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
<b>Mësuesi drejton pyetje të niveleve</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi</i>

<b>dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi.</b>	<i>demonstron që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>demonstron që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>demonstron që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi dhe njëri – tjetrit.</i>
--	--	--	---	--

### Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)

<b>Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimi.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi.</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
<b>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes.</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstron se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstron se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>

<b>Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënimit dhe nevojave të nxënësve</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënimit apo nevojat e nxënësve.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënimit dhe nevojave të tyre.</i>
<b>Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)</b>				
<b>Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënimit të temës mësimore.</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
<b>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore,</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënimit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK.</i>	4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënimit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

